



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

#### V E N D I M

**Nr. 145, Datë 02/07/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 41, datë 19.03.2018, e Znj. A. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes civile”<sup>1</sup>, “përgjegjësisë prindërore”<sup>2</sup> dhe “identitetit gjinor”, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

#### K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Znj. A. B. është e punësuar që prej vitit 2009, pranë Universitetit të Tiranës dhe së fundmi ka ushtruar detyrat në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Juridik, pranë Drejtorisë Juridike, të Rektoratit të Universitetit të Tiranës.

<sup>1</sup> Referuar çertifikatës familjare të ankueses rezulton se është e divorcuar;

<sup>2</sup> Ankuesja është kryefamiljare dhe ka në ngarkim vajzën e saj, 6 vjeçare;

Ankuesja pretendon se situata diskriminuese ndaj saj ka filluar që në momentin, kur në Rektorat u shfaq problematika e kalimit me vonesë të pagave të muajve gusht – shtator 2017, të punonjësve të këtij institucioni, çështje për të cilën, ajo është interesuar zyrtarisht pranë Rektorit dhe Kancelarit të këtij institucioni. Që nga ajo periudhë, Znj. A. B. pretendon se është gjendur para diskriminimit, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës, i cili e ka mbingarkuar me detyra dhe me punë të papërbalueshme, duke i kërkuar të realizojë detyra, të cilat nuk bënin pjesë në përshkrimin e saj të punës, duke ngarkuar të hartojë shkresa me përmbajtje jo etike dhe me gjuhë jo korrekte profesionalisht drejtuar Dekanëve të Fakulteteve, gjë që ka shkaktuar si pasojë indinjatë dhe konflikte personale me ankuesen. Znj. A. B. pretendon se i është kërkuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës, të mos pranojë urdhëra dhe shkresa nga Kancelari i institucionit, duke shkaktuar përballje dhe konflikte me këtë të fundit. Ankuesja shprehet se pavarësisht sa më sipër, ajo ka mundur ta përballojë të gjithë këtë situatë, duke realizuar me përkushtim detyrat e ngarkuara, pavarësisht se një gjë e tillë ka patur kosto për të pasi ka lënë pas dore fëmijën e saj të mitur.

Në vijim të kësaj situatë, me vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, e Rektorit të Universitetit të Tiranës është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëherëshme me Znj. A. B. Ankuesja pretendon se para daljes së këtij vendimi, ajo nuk është njoftuar dhe nuk është paralajmëruar. Ajo është informuar mbi këtë vendim nga Administratori i Universitetit të Tiranës, i cili ka relatuar rastin e saj në Bordin e Administrimit, duke iu referuar relacionit të datës 20.12.2017.

Bordi i Administrimit, në cilësinë e organit më të lartë kolegjal të Universitetit të Tiranës për çështjet administrative dhe financiare, me vendimin nr. 28, datë 21.12.2017, ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të Universitetit të Tiranës, si një akt të dalë në kundërshtim me kompetencat funksionale që Rektori ka në bazë të nenit 39, pika 5, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”<sup>3</sup>.

Vendimi i Bordit të Administrimit është përcjellë për zbatim pranë Administratorit dhe ankuesja ka vazhduar ushtrimin e detyrave të saj normalisht, deri në momentin, kur ka marrë dijeni mbi faktin, që pozicioni i saj i punës është shpallur vakant në Buletinin nr. 9, datë 05.03.2018, e Agjensisë së Prokurimit Publik. Për sa më sipër, Znj. A. B. e konsideron në veprim të tillë të kundraligjshëm dhe diskriminues për shkaqet e sipërpërmendura, në një kohë, kur ajo ende punon në detyrën e Përgjegjëses së Sektorit Juridik dhe deri më sot nuk është kryer asnjë

---

<sup>3</sup> Pika 5, e nenit 39, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë”.

procedurë disiplinore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe as nuk i është paraqitur ndonjë njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës me Universitetin e Tiranës.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Në vijim të korrespondencës me e-mail, ku Znj. A.B. iu kërkua të plotësonte dokumentacionin e dorëzuar në cilësinë e provës, si dhe të plotësonte rubrikat e paplotësuara në formularin e ankesës, në datën 29.03.2018, ankuesja u paraqit pranë zyrës së Komisionerit, ku dorëzoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar. Referuar procesverbalit të takimit, datë 29.03.2018, Znj. A. B. hoqi dorë prej njërit nga shkaqet e diskriminimi të pretenduar<sup>4</sup> në formularin e ankesës, si dhe ra dakord që pjesën e mbetur të dokumentacionit plotësues, ta dërgonte me e-mail, në ditët në vijim.
2. Pas analizimit të informacionit të dërguar nga ankuesja, mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 406/1, datë 05.04.2018, Rektorit të Universitetit të Tiranës dhe për dijeni Administratorit dhe Kryetares së Bordit të Administrimit të UT, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja A. B.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 406/1, datë 05.04.2018, së Komisionerit, Z. Mynyr Koni, Rektor i Universitetit të Tiranës dërgoi shkresën nr. 1660/1, datë 02.05.2018, ku parashtrohen sqarimet përkatëse mbi pretendimet e ankueses.

Sipas shkresës në fjalë, Znj. A. B. ka ushtruar detyrën e Përgjegjës të Sektorit Juridik, pranë Rektoratit të UT, deri në datën 19.12.2017, moment, kur nëpërmjet Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të UT, ajo është liruar nga detyra.

Pagat e muajve gusht-shtator 2017, të punonjësve të Rektoratit, janë kaluar me vonesë, për shkak të problemeve të brendshme të institucionit. Në lidhje me këtë vonesë janë interesuar, si pranë Rektorit, ashtu edhe pranë Kancelarit të UT (zyrtarisht dhe jo zyrtarisht) edhe punonjës të tjerë të Rektoratit. Duke marrë shkas nga ky shqetësim i punonjësve, Rektori ka mbledhur në 2 takime,

---

<sup>4</sup>Ankuesja kishte cilësuar “identitetin gjinor” si një ndër shkaqet e diskriminimit. Pasi inspektorja e çështjes e sqaroi në lidhje me kuptimin e shkakut në fjalë, ankuesja hoqi dorë nga ky shkak diskriminimi.

<sup>5</sup>Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

përkatësisht në datën 14.09.2017, ora 10:15 dhe datë 03.10.2017, ora 10:00 të gjithë punonjësit e Rektoratit, duke shprehur mbështetjen e tij për zgjidhjen sa më të shpejtë të këtij problemi. Në lidhje me këtë problem, punonjës të Rektoratit të UT, duke përfshirë këtu edhe ankuesen, i kanë paraqitur petition Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Shqetësimi i të gjithë punonjësve të Rektoratit është konsideruar mëse i drejtë nga ana e Rektorit, i cili ka qenë në mbështetje të punonjësve për zgjidhjen e tij. Në këtë kontekst, Rektori i UT hedh poshtë pretendimin e ankueses se fillimi i diskriminimi të saj nga ana e titullarit të institucionit ka ardhur si pasojë e kësaj ngjarjeje. Njëkohësisht, Rektori deklaroi si të pavërtetë pretendimin e saj, se ai e ka mbingarkuar ankuesen me detyra dhe me punë të papërbalueshme.

Për sa më sipër, në shkresën e dërguar nga Rektori i UT theksohet fakti, se gjatë periudhës gusht-dhjetor 2017, Rektori i Universitetit të Tiranës ka patur një Drejtor Juridik, i cili kryente ndarjen e detyrave tek punonjësit brenda drejtorisë së tij, sipas ngarkesës përkatëse të tyre. Ankueses nuk i është ngarkuar asnjë detyrë drejtpërdrejt nga Rektori i UT. Për këtë, Rektori i referohet nenit 9/II, Kreu III, i Rregullores së Brendshme të Punës “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT”. Në shkresë theksohet fakti se ankuesja, e cila mbante pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Juridik, pranë Drejtorisë Juridike të Rektoratit, ishte në varësi të Drejtorit Juridik dhe nuk mund të merrte detyra direkte nga Rektori apo nga Administratori i UT, pasi vetëm drejtori i drejtorisë bënte ndarjen e punës në drejtorinë që mbulonte.

Për shkak të mosplotësisht të kërkesave të punës, mosrespektimit të hierarkisë së brendshme dhe thyerjes së disiplinës në punë (skena të papërshtatshme, jo etike), ndaj kësaj punonjësjeje është marrë masa disiplinore e largimit të menjëhershëm nga puna, nëpërmjet Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të UT. Në shkresë theksohet fakti se edhe pas lirimit të saj nga detyra, punonjësja vazhdon të paguhet në mënyrë abuzive nga ana e Administratorit të UT, Z. S. D., për punë dhe detyra që nuk kanë lidhje me Drejtorinë Juridike. Një gjë e tillë është e provueshme edhe në zyrën e Protokoll Arkivit të UT, në të cilin nuk ekziston asnjë punë e kryer nga ankuesja në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit Juridik. Për sa më sipër, ndaj Administratorit të UT është bërë kallëzim penal për shpërdorim detyre.

Rektori thekson faktin se në këtë çështje nuk gjendemi para diskriminimit të një punëmarrësi në vendin e punës, por jemi para përfitimit të privilegjeve, në mënyrë tërësisht të padenjë dhe të pajustificuar nga ana e saj, pasi ankuesja vazhdon të përfitojë pagën e saj edhe pse është larguar nga puna me Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të UT.

Rektori hedh poshtë pretendimin e ankueses se nuk ka marrë njoftim për vendimin e largimit nga puna, pasi ka qenë vetë ankuesja që e ka refuzuar marrjen e njoftimit, i cili në vijim i është njoftuar nëpërmjet adresës së e-mailit.

Ankuesja e mbështet qëndrimin e saj, në vendimin nr. 28, datë 21.12.2017, të Bordit të Administrimit, i cili ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit. Në lidhje me këtë vendim, Rektori sqaron se UT nuk i ka miratuar ende aktet e reja nënligjore, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë arsye, aktualisht zbatohen aktet ekzistuese. Mbështetur në pikën 12<sup>6</sup>, të nenit 39 të ligjit të sipërpërmendur, ku parashikohen kompetencat e Rektorit, neni 25 i Statutit të UT parashikon: “*Rektori është autoriteti më i lartë drejtues, ekzekutiv e urdhërdhënës i UT-së, i cili vec sa është përcaktuar në ligj ka edhe detyra e kompetenca:.....8. Nënshkruan kontratat e punës për të gjithë personelin e UT*”. Në cilësinë e titullarit të institucionit, Rektori është i vetmi autoritet që njihet si nga ligji, ashtu edhe nga Statuti për të krijuar dhe për të shuar marrëdhënie pune në UT, që do të thotë se është përfaqësuesi i palës punëdhënëse në kontratat e punës, që lidhen dhe zgjidhen me punëmarrësit. Kompetenca për të disponuar në lidhje me marrëdhëniet e punës nuk i njihet asnjë autoriteti tjetër, përfshirë këtu Bordin e Administrimit, apo Administratorit të UT-së. Kompetencat e Bordit të Administrimit përcaktohen në nenin 49, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa ato të Administratorit parashikohen në nenin 52, të ligjit të sipërpërmendur. Rektori sqaron se në rast se do të analizohen nenet përkatëse, as Bordi dhe as Administratori nuk kanë të drejtë për të disponuar në marrëdhëniet e punës. Gjithashtu, Bordit nuk i njihet e drejta për të kontrolluar, shfuqizuar, revokuar apo deklaruar pavlefshmërinë absolute apo relative të akteve të nxjerra nga Rektori. Pra, vendimet e Bordit nuk mund të krijojnë kurrësesi pasoja mbi vendimet e Rektorit të UT. Ligji nr. 80/2015 parashikon se Bordi i Administrimit është një organ kolegjal me detyra të përcaktuara në mënyrë strikte, Organet kolegjiale i kanë funksionet të parashikuara shprehimisht në ligj dhe nuk kanë asnjë dispozitë blanket. Përkundrazi, ato janë kufizuese, dmth vetëm për sa parashikohet shprehimisht në ligj.

Në dokumentacionin bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, ndër të tjera, Rektori i UT ka përcjellë edhe shkresën nr. K1/S3-6 Prot., datë 13.03.2018 “Rekomandohet marrja e masave të menjëherëshme për pagesën e punonjësve S. C., L. G., N. M. dhe L. M.”, të institucionit të Avokatit të Popullit. Shkresa në fjalë është dërguar pas depozitimit të ankesës së disa punonjësve të Rektoratit, të cilët janë emëruar si specialistë të institucionit me Vendim të Rektorit, por që

---

<sup>6</sup> Pika 12 e nenit 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. parashikohet: “*Funksione të tjera të rektorit përcaktohen në statutin e institucionit*”.

prej fillimit të punës së tyre, ata nuk janë paguar nga ana e ish-Kancelarit R. S. dhe as me emërimin e Administratorit të ri, Z. S. D. Kërkesa e punonjësve është shqyrtuar nga Avokati i Popullit, i cili ka dalë në rekomandim për marrje masash nga ana e Administratorit të UT për pagesën e punonjësve të sipërpërmendur.

Rektori gjithashtu e informon Komisionerin, se Znj. A. B. ka bërë kërkesë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për sigurim padie dhe për pezullim të kryerjes së veprimeve nga organi publik për zhvillimin e procedurës së konkurimit për pozicionin e punës “përgjegjëse e sektorit juridik”, pranë Rektoratit të UT, deri sa gjykata të shprehet mbi themelin e padisë. Me vendimin nr. 80-2018-1058, datë 21.03.2018, gjykata administrative është shprehur për moskompetencën e saj dhe dërgimin e akteve të dosjes pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

-Në përgjigje të shkresës nr. 406/1, datë 05.04.2018, së Komisionerit, Z. S. D., Administrator i Universitetit të Tiranës dërgoi shkresën nr. 1797, datë 16.04.2018, ku parashtrohet informacionin e tij, lidhur me pretendimet e Znj. A. B.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, Znj. A. B. është e punësuar në Drejtorinë Juridike të Universitetit të Tiranës që prej vitit 2009. Detyrën e përgjegjëses së sektorit, ankuesja e mban që prej vitit 2016. Ajo është e punësuar me kontratë individuale punë me afat të pacaktuar, të lidhur në datën 10.02.2016. Znj. A. B. aktualisht punon në detyrën e sipërcituar edhe pse me Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, Rektori i UT ka vendosur zgjidhjen e menjëherëshme të marrëdhënies së punës me këtë punonjëse. Nëpërmjet vendimit nr. 28, datë 20.12.2017, Bordi i Administrimit ka vendosur pavlefshmërinë absolute të Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit, i cili zgjidh marrëdhëniet e punës me ankuesen. Në vijim, duke iu referuar dokumentacionit bashkelidhur shkresës rezulton se nëpërmjet Vendimit nr. 188, datë 21.12.2017, të Rektorit të UT, Vendimi i sipërpërmendur i Bordit të Administrimit të UT është shpallur absolutisht i pavlefshëm, si një akt i nxjerrë në tejkalim të kompetencave.

Administratori i UT shprehet se që nga marrja e detyrës, në datën 07.12.2017 e deri më sot, ai është ndeshur me një sërë problematikash shumë shqetësuese dhe të rënda në Rektorat. Problemi kryesor ka qenë dhe vazhdon të jetë marrja e kompetencave të Administratorit dhe të Bordit të Administrimit të UT, nga Rektori. Këto problematika kanë qenë subjekt kontrolli nga disa grupe inspektimi të Ministrisë së Arsimit, Sportit. Konkretisht, sipas kontrollit të fundit të ushtruar në muajin shkurt 2018, duke iu referuar projekt-Kontrollit të datës 30.03.2018, të MASR-së rezulton se Rektori i UT ka kryer shkelje të rënda, ku një ndër shkeljet e konstatuara ka qenë largimi i padrejtë nga puna i Znj. A. B..

Administratori i UT thekson faktin, se menjëherë pas marrjes së detyrës, ai i ka ngarkuar përgjegjëses së Sektorit Juridik, disa detyra të menaxhimit të përditshëm të institucionit, të cilat ajo i ka kryer me sukses. Ankuesja i ka bërë prezent Administratorit S. D., që në fillim, se Rektori i ka kërkuar të mos pranojë detyrat dhe urdhërat e ish-Kancelarit, Z. R. S. Njëkohësisht, Znj. A. B. e ka bërë me dije, në lidhje me faktin se marrëdhëniet e saj të punës me Rektoren kanë qenë të rënduara, për shkak se në muajin tetor 2017, punonjësit e Rektoratit nuk kishin marrë pagat e muajve gusht-shtator 2017 dhe ajo i ka kërkuar disa herë pagat mujore, Rektorit, Administratorit dhe Drejtores së Financës dhe Buxhetit të Rektoratit. Administratori i UT thekson faktin se punonjësit e Rektoratit nuk marrin pagat mujore, për arsye të pengesave nga ana e Rektorit, nëpërmjet shantazhit të bërë ndaj Drejtores së Financës dhe Buxhetit të Rektoratit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, duke arritur deri në ndërshkim me masë disiplinore.

Administratori shprehet se institucionalisht nuk gjen ndonjë arsye tjetër, përveç arsyes me motivacion personal, hakmarrjeje dhe diskriminimi ndaj Znj. A. B., nga ana e Rektorit, pasi më parë nuk ka patur ndaj saj asnjë procedim disiplinor ose tërheqje vëmendjeje. Znj. A. B. ka demonstruar përkushtim dhe vullnet në përmbushjen e detyrave, por ndaj saj vihet re një sjellje jo etike dhe aspak miqësore nga ana e Rektorit dhe e disa strukturave të tjera të Rektoratit, për periudhën Dhjetor 2017 e deri më sot.

Në shkresë theksohet fakti se e njëjta situatë është shkaktuar nga Rektori edhe për disa punonjëse të tjera në Rektoratin e UT, të gjinisë femër, për të cilat gjithashtu nuk ka patur shkak/motivacion për shkak të punës. Këto punonjëse janë: Znj. M. Th. (për të cilën gjykata është shprehur me pranimin e kërkesëpadisë duke konstatuar shkelje të Rektorit për largimin e saj nga puna); Znj. S.B. (të larguar pa motivacion), Znj. I. B. (ndërprerë kontrata e punës pa shkaqe të arsyeshme), Znj. F.B. (ndërshkuar me masë disiplinore dhe larguar pa shkaqe të arsyeshme) etj.

Situata paraqitet e agravuar, pasi në Buletinin e APP nr. 9, datë 05.03.2018, janë publikuar 6 pozicione pune në Rektorat, ndër të cilat edhe ai i përgjegjës të Sektorit Juridik. Ndërkohë, me Vendimin nr. 40, datë 28.03.2018, të Rektorit është emëruar në detyrë Z. E.M, me kontratë pune 3-mujore. Administratori thekson faktin se ky punonjës nuk do të paguhet, edhe pse Rektori këmbëngul në shkeljen e tij.

**3.** Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 406/4, datë 14.05.2018, palët u njoftuan për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pretendimet e tyre. Seanca dëgjimore u zhvillua më datën 18.05.2018, pranë Zyrës së Komisionerit.



Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesja A. B., Z. S. D., Administrator pranë Rektoratit të UT, Znj. N. M., përfaqësuese e Rektorit të Universitetit të Tiranës<sup>7</sup>, Znj. N. D., përfaqësuese e Bordit të Administrimit të UT<sup>8</sup>.

- ⇒ Fillimisht, ankuesja A. B. parashtoi pretendimet e saj për diskriminim, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës, Z. M. K., për shkak të “gjinisë”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes civile” dhe “përgjegjësisë prindërore”.

Ankuesja u shpreh se punon që prej vitit 2009, pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës. Gjithnjë është dalluar për punën e saj të mirë dhe ndaj saj nuk është marrë asnjëherë masë disiplinore, deri në momentin kur ndaj saj është dhënë Vendimi nr. 184, datë 19.12.2017, i Rektorit të UT, nëpërmjet së cilit është vendosur largimi i saj nga puna. Ankuesja thekson faktin se, Bordi i Administrimit të UT, nëpërmjet vendimit të tij nr. 28, datë 21.12.2017, ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit. Ankuesja u shpreh se konflikti i saj me Rektorin ka filluar në muajt gusht-shtator 2017, kur pagat e punonjësve të Rektoratit, janë kaluar me vonesë, për shkak të problemeve të brendshme të institucionit. Ajo ka paraqitur shkresa dhe memo pranë Rektorit dhe Kancelarit të mëparshëm për zgjidhjen e situatës dhe kalimin e pagave për punonjësit e Rektoratit. Ankuesja theksoi faktin se Rektori i ka ngarkuar punë të papërbalueshme, si dhe shpeshherë i janë dhënë detyra, që nuk i takonin, në bazë të përshkrimit të saj të punës apo është ngarkuar të hartojë shkresa me përmbajtje aspak etike. Njëkohësisht, Znj. A. B. u shpreh se ka marrë urdhëra verbale nga Rektori për të mos marrë detyra nga Administratori i Rektoratit të UT. Ndërkohë që, Z. S. D., Administrator pranë këtij institucioni i ka ngarkuar detyra, të cilat ajo i ka zbatuar. Në vijim Rektori ka shpallur vakant pozicionin e saj të punës, në Buletin nr. 9 të APP. Vendimi nr. 184, datë 19.12.2017, i Rektorit, për largimin e ankuses nga puna, është konstatuar në shkëlqje të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës në Projekt-Raportin nr. 3411/1, datë 30.03.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ankuesja theksoi faktin se Rektori ka dijeni për gjendjen e saj familjare dhe që ka në ngarkim një fëmijë të mitur, për të cilin ajo ka përgjegjësinë kryesore për rritjen e tij dhe pavarësisht kësaj, ai ka marrë një vendim për largimin e saj nga puna, vendim i cili është tërësisht i pambështetur. Ajo gjithashtu, përmendi faktin, se vazhdon të punojë në Rektorat dhe merr detyra nga Administratori i Rektoratit dhe se përveç sa më sipër, zgjidhja e kontratës së saj të punës, nga ana e Rektorit të UT, ka ardhur, mbi te gjitha, edhe se ajo është

<sup>7</sup> Me autorizimin nr. 2259/1, datë 21.05.2018, të lëshuar nga Rektori i UT.

<sup>8</sup> Me autorizimin nr. 264, datë 18.05.2018, të lëshuar nga Kryetarja e Bordit të Administrimit të UT.



konsideruar mbështetëse e Administratorit dhe ka zbatuar urdhërat dhe detyrat e ngarkuara nga ana e tij.

2. Në vijim, përfaqësuesja me autorizim e Rektorit të Universitetit të Tiranës, Znj. N. M., e cila mban pozicionin e Drejtores Juridike prane këtij institucioni parashtrori prapësimet e saj, në lidhje me pretendimet e ankueses. Znj. N. M. u shpreh se ndaj ankueses është marrë vendimi nr. 184, datë 19.12.2017, i Rektorit për largimin e saj nga puna pasi, punonjësja ka kryer shkelje, të cilat janë të përcaktuara shprehimisht në këtë vendim. Vendimi i sipërpërmendur i është komunikuar me protokoll ankueses, por ajo ka refuzuar ta marrë në dorëzim.

Lidhur me çështjen e vonesës në kalimin e pagave për muajt gusht – shtator 2017, për punonjësitet e Rekoratit, Znj. N. M. u shpreh se Rektori ka shprehur predispozicionin dhe interesin e tij, të drejtpërdrejtë, për të ndihmuar punonjësitet dhe ka zhvilluar disa takime me ta. Sikurse, Znj. A. B. edhe punonjësitet të tjerë kanë shprehur shqetësimin e tyre nëpërmjet ankesave me shkrim drejtuar Rektorit dhe Administratorit, apo edhe drejtuar Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Në këtë mënyrë, Znj. N. M. e ka përjashtuar mundësinë e reagimit, apo hakmarrjes së Rektorit ndaj ankueses për këtë arsye.

Përfaqësuesja e Rektorit e ka kundërshtuar pretendimin e ankueses se i është ngarkuar punë e papërbalueshme nga Rektori, si dhe i janë dhënë të kryejë detyra që nuk përfshihen në përshkrimin e saj të punës, me argumentimin se në Drejtorinë Juridike detyrat ndahen nga Drejtori dhe punonjësitet nuk marrin detyra në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Rektori. Lidhur me ngarkimin e detyrave për hartimin e shkresave me përmbajtje jo-etike, Znj. N. M. theksoi faktin se ankuesja nuk disponon prova për të vërtetuar një gjë të tillë. Ndër të tjera, ajo u shpreh se ankuesja është toleruar në raste kur ka munguar në punë për arsye shëndetësore të fëmijës së saj, apo kur ka munguar në seanca gjyqësore, ku ka qenë e autorizuar të përfaqësojë Rekoratin dhe ka lajmëruar për mungesën, vetëm pak orë para fillimit të seancës. Znj. N. M. theksoi faktin se Znj. A. B. ka shfaqur probleme, lidhur me respektimin e hierarkisë, pasi ajo ka qenë në varësi të Drejtorit Juridik dhe nuk kishte arsye përse të merrte detyra të drejtpërdrejta nga Administratori. Ajo shprehet se vendimi për largimin nga puna të ankueses është bërë për shkaqe të justifikuara. Rektori ka humbur besimin tek punonjësja dhe si rrjedhim nuk mund të punonte më me të. Znj. N. M. u shpreh se ankuesja paraqitet në Rekorat, por nuk mban më të njëjtin pozicion pune, pavarësisht se vazhdon të paguhet nga Administratori i Rekoratit, fakt të cilin ajo e konsideroi shkelje të tij. Ndër të tjera, përfaqësuesja e Rektorit u shpreh se Bordi i Administrimit të UT nuk ka tagër për shpalljen e pavlefshmërisë së vendimeve të Rektorit dhe ky i fundit, në cilësinë e titullarit të institucionit nuk merr urdhëra nga Bordi. Znj. N. M. u shpreh se pavarësisht faktit se ankuesja vazhdon të paguhet, ajo nuk konsiderohet më punonjëse e Rekoratit, pasi pozicioni i

punës “përgjegjëse e sektorit juridik” është shpallur vakant në Buletinin e APP. Znj. N. M u shpreh se lidhur me procedurën e ndjekur nga Rektori për zgjidhjen e kontratës së punës, ankuesja ka të drejtë të ankohet në gjykatë.

E pyetur nga Komisioneri, nëse ndaj ankueses është marrë ndonjë masë disiplinore paraprakisht dhe se kur janë konstatuar shkeljet e Znj. A. B., përfaqësuesja e Rektorit u shpreh se nuk i është dhënë asnjëherë masë disiplinore me shkrim, por i është tërhequr vëmendja verbalisht. Zgjidhja e kontratës ka qenë e menjëherëshme, për shkak të humbjes së besimit të punëdhënësit.

Ndër të tjera, Znj. N. M iu kërkuar Relacioni bashkëlidhur vendimit, nëpërmjet së cilit vërtetohen shkeljet e kryera nga ankuesja, të cilin përfaqësuesja e Rektorit ra dakord që do ta dërgonte në vijim të seancës dëgjimore, bashkë me prova të tjera që iu kërkuan në këtë seancë.

Në seancën dëgjimore, Komisioneri shtroi pyetjen nëse ekzistonte një konflikt institucional, ndërmjet Rektorit dhe Administratorit të Rektoratit. Përgjigja e kësaj pyetje u mor nga palët në proces, të cilët pohuan faktin që realisht ekziston një konflikt i tillë. Një fakt i tillë u përforcua nga Znj. N. D., anëtare e Bordit të Administrimit të UT dhe Administratorit S. D., i cili ndër të tjera u shpreh se zgjidhja e kontratës së punës së ankueses nga Rektori, ishte e padrejtë, pasi Vendimi i Rektorit nuk ka qenë i mbështetur, si ligjërisht në momentin e miratimit të tij, ashtu edhe në fakte dhe prova. Z. S. D. u shpreh se konflikti ndërmjet dy titullarëve e ka zanafillën në ndarjen e kompetencave që ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, u atribuon atyre. Znj. N. D., u shpreh se si pasojë e këtij konflikti, administrata e Rektoratit është përçarë në dy grupe që konsiderohen mbështetës të Rektorit dhe mbështetës të Administratorit. Ata punonjës që janë pa përkrahje janë larguar nga puna. Rektorati vazhdon të zbatojë aktet nënligjore në zbatim të ligjit të mëparshëm dhe aktualisht të shfuqizuar për arsimin e lartë, pasi nuk ka nxjerrë aktet e reja në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i cili është në fuqi.

Z. S. D. u shpreh se që nga momenti që ka marrë detyrën e Administratorit, ka konstatuar problematika serioze. Ai theksoi faktin se shkeljet e Rektorit janë konstatuar shprehimisht në Projekt-Raportin e Kontrollit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Ndër të tjera, në këtë Projekt-Raport, Vendimi nr. 184, datë 19.12.2017, i Rektorit, për largimin e ankueses nga puna, është konstatuar në shkelje në dispozitave përkatëse ligjore.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga palët që të paraqiteshin provat e kërkua në seancë, si dhe pretendimet dhe prapësimet e tyre përfundimtare me shkrim.

4. Nëpërmjet shkresës nr. 2259/2, datë 25.05.2018, Rektori i Universitetit të Tiranës, kërkoi të dispononte provat e depozituara pranë Komisionerit nga ankuesja, të cilat iu përcollën bashkëlidhur shkresës nr. 759/1, datë 29.05.2018, të Komisionerit.
5. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 2259/4, datë 11.06.2018, Rektori dërgoi kundërshtimet e tij dhe prova shtesë, në lidhje me ankesën e Znj. A. B.

Në shkresën e sipërpërmendur, Rektori i Universitetit të Tiranës thekson faktin se Znj. A. B. është larguar nga detyra “Përgjegjëse e Sektorit Juridik”, pranë Rektoratit të Tiranës, me Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të UT, që do të thotë që ajo nuk është më në marrëdhënie pune me Rektoratin, pasi kontrata e saj e punës është e zgjidhur nga punëdhënësi, në referencë të nenit 153, pika 1, të Kodit të Punës. Në shkresë theksohet fakti se shkaqet, të cilat, sipas parimit të mirëbesimit nuk mund të lejonin vazhdimin e marrëdhënieve të punës, janë të renditur në vendimin e sipërpërmendur. Në referencë të nenit 153, pika 3, të Kodit të Punës është gjykata që vendos nëse shkaqet që kanë çuar në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, janë të justifikuara ose jo. Prandaj, shkaqet (të cilat lidhen me shkeljet e rënda të detyrimeve kontraktuale të punës) dhe provat përkatëse që kanë çuar në zgjidhjen e menjëherëshme të punës, do të mbeten në vlerësim dhe kompetencë të gjykatës, nëse ankuesja do t’i drejtohet kësaj të fundit. I njëjti qëndrim mbahet nga Rektori edhe për sa i takon zbatimit apo jo të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Në vijim, në shkresën e tij, Rektori kundërshton pretendimet për diskriminim të ankuses duke dhënë sqarimet përkatëse për çdo shkak të cituar nga Znj. A. B..

6. Nëpërmjet shkresës nr. 759, datë 29.05.2018, ankuesja A. B., parashtrori pranë Komisionerit, prova të tjera, nëpërmjet së cilave ajo mbështet pretendimet e saj.

Në shkresën e dërguar nga ankuesja përcillet informacion, lidhur me raste, kur Rektori ka mbajtur qëndrime të ndryshme për situatë të njëjta, lidhur me punësime dhe largime nga puna në Rektorat. Në këtë kontekst, Znj. A. B. vë në vëmendje të Komisionerit disa fakte mbi disa punonjës të Rektoratit që janë larguar me masa disiplinore, si dhe disa punonjës të tjerë, të cilët janë përkrahur nga Rektori, ndërkohë që këta të fundit kanë patur masa disiplinore të dhëna nga ana e Kancelarit/Administratorit.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 41, datë 19.03.2018, e Znj. A. B., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioneri vlerëson se:**

**I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 41, datë 19.03.2018, rezulton se Znj. A. B., ka qenë punonjëse pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës, që prej vitit 2009. Prej vitit 2016, Znj. A. B. ka punuar ne pozicionin e “Përgjegjës së Sektorit Juridik”, të Drejtorisë Juridike të Rektoratit të Universitetit të Tiranës. Ajo është e punësuar me kontratë individuale punë me afat të pacaktuar, të lidhur në datën 10.02.2016. Me Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, Rektori i UT ka vendosur zgjidhjen e menjëherëshme, të justifikuar të marrëdhënies së punës me këtë punonjëse.

Nëse do t’i referohemi aktit administrativ të sipërpërmendur, të Rektorit të Universitetit të Tiranës, rezulton se motivacioni për shkak të së cilit, është kryer zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës së Znj. A. B. është si vijon: *“Sot, në datën 19.12.2017, pasi konstatova raste të përsëritura të shkeljeve gjatë kryerjes së punës dhe detyrave funksionale nga znj. A. B., nëpërmjet së cilave rezulton se ka shkelur nenin 9, pika II/5 të Rregullores së Brendshme të Rektoratit të UT-së; nuk ka zbatuar porosinë dhe Urdhërat e Rektorit të UT-së; nuk ka respektuar hierarkinë institucionale, si brenda Drejtorisë Juridike ashtu edhe me titullarin e institucionit; ka hartuar dokumentacione që vijnë krejtësisht në kundërshtim me njëra tjetrën, për të njëjtën çështje dhe për të njëjtën situatë ligjore; ka shkelur Kodin e Etikës të UT-së, të gjitha këto të evidentuara dhe provuara, pavarësisht tërheqjes së vëmendjes në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Rektorit të UT-së””.*

Mbështetur në Vendimin e Rektorit, vihet re se Znj. A. B. ka kryer një sërë shkeljesh, të cilat duke iu referuar citimit të sipërpërmendur, rezulton se është shënuar: *“të gjitha këto të evidentuara dhe provuara...”*. Për sa më sipër, rezulton se Rektori, në aktet e depozituara në cilësinë e provës, nuk ka përcjellë asnjë akt administrativ, që provon shkeljet e kryera nga Znj. A. B., aq më tepër, kur në vendimin e sipërpërmendur thuhet shprehimisht se shkeljet janë të evidentuara dhe provuara.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësueses së Rektorit iu kërkua Relacioni Shoqërues i Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit, si dhe provat dhe faktet që dispononin, mbi bazën e së cilave, Znj. A. B. i është zgjidhur kontrata e punës. Në vijim të seancës dëgjimore, provat e sipërpërmendura nuk u dërguan pranë Komisionerit, me arsyetimin se çështje të tilla gjenin zgjidhje vetëm gjyqësisht. Në këtë kontekst, Komisioneri e gjen me vend të gjykojë se për sa

kohë Rektori nuk i është përgjigjur kërkesës së tij dhe nuk ka depozituar provat e kërkuara në një proces shqyrtimi administrativ të ankesës së një punonjëseje, e cila pretendon diskriminim, pasi i është zgjidhur kontrata e punës, këto prova nuk ekzistojnë.

*Së dyti*, në pjesën e cituar në Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit thuhet shprehimisht: “...pavarësisht tërheqjes së vëmendjes në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Rektorit të UT-së”. Tërheqja e vëmendjes në mënyrë të vazhdueshme nënkupton se shkeljet e Znj. A. B. kanë patur një kohëzgjatje të konsiderueshme. Në këtë kontekst, presupozohet që ndaj Znj. A. B. duhet të jenë dhënë paraprakisht masa disiplinore, më të lehta, derisa Rektori me vendimin e sipërpërmendur, i zgjidhi kontratën e punës, në mënyrë të menjëherëshme dhe për shkaqe të justifikuara. Për sa më sipër, gjatë shqyrtimit të provave të depozituara në këtë proces administrativ rezulton se Znj. A. B. nuk ka qenë asnjëherë subjekt i dhënies së ndonjë mase disiplinore. Rektori nuk ka depozituar në cilësinë e provës asnjë akt administrativ që të vërtetojë faktin se ankueses i është dhënë masë disiplinore paraprake dhe asnjë procesverbal, ku të rezultojë se asaj i është tërhequr vëmendja nga ana e Rektorit, për ndonjë nga motivacionet e përmendura në Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017.

Njëkohësisht, në këtë kontekst vlejnë për t’u theksuar edhe përfundimet e ekipit të kontrollit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht në pikën C/9/a të Projekt-Raportit nr. 3411/1, datë 30.03.2018, ku është cituar shprehimisht:

*“Vendimi i Rektorit nr. 184, datë 19.12.2017 “Për zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës në UT të Znj. A. B.”, Përgjegjëse e Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike”, sipas së cilës rezulton se ka shkelur pikën 2.5 të nenit 9 të Rregullores së brendshme të Rektoratit të UT. Si në vendimin e Rektorit dhe në dokumentet e vëna në dispozicion nuk ka fakte/prova që të provojnë se kjo punonjëse nuk ka kryer detyrat sipas nenit 9, pika 2.5 të Rregullores së Brendshme të Rektoratit të UT-së. Në nenin 9, pika 2 (drejtoria juridike) të kësaj rregulloreje nuk janë të përcaktuara në mënyrë specifike detyrimet për çdo pozicion pune, pra nuk janë të specifikuar detyrimet e secilit punonjës, sipas pozicionit, jo vetëm për drejtorinë juridike, por për të gjithë drejtorinë e Rektoratit të UT-së. Bazuar në Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë, Znj. A. B. ka varësi administrative nga Rektori i UT, por në kohën e nxjerrjes së Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017 të Rektorit, kjo varësi administrative nuk ka qenë e përcaktuar me akt nënligjor”.*

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se motivacionet, mbi bazën e së cilave, Znj. A. B., i është zgjidhur marrëdhënia e punës, janë të pambështetura në fakte dhe prova konkrete.

Për sa më sipër, në referencë të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Znj. A. B. i është nënshtruar dhe ekspozuar një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

## **II. Shkaqet e pretenduara të diskriminimit.**

Në ankesën nr. 41, datë 19.03.2018, e Znj. A. B., pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes civile”, “përgjegjësisë prindërore”, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

“Gjinia”, “gjendja ekonomike”, “gjendja shoqërore”, “gjendja civile” dhe “përgjegjësia prindërore” janë disa prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⇒ Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjinisë”, mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe duke iu referuar specifikisht pikës 11, të Projekt-Raportit nr. 3411/1, datë 30.03.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rezulton se sikurse ankuesja, ka patur edhe punonjës të tjerë, të cilët ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të. Këta janë punonjës, të cilëve iu është zgjidhur kontrata e punës të mënyrë të menjëherëshme dhe justifikuar, si më poshtë:

1. Me Vendimin nr. 11, datë 20.10.2017 të Rektorit “Për zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës në UT të punonjësit administrativ Znj. S. A.” përfundojnë marrëdhëniet e punës për Përgjegjësen e Sektorit të Infrastrukturës;
2. Me Vendimin nr. 124, datë 31.08.2017 të Rektorit “Për zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës në UT të Z. B. F.” përfundojnë marrëdhëniet e punës për njërin nga punonjësit, i cili mbante pozicionin “shofer” në UT;
3. Me Vendimin nr. 128, datë 06.09.2017, e Rektorit “Për zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës në UT të Znj. M. Th.” përfundojnë marrëdhëniet e punës

për specialisten e auditit të UT. (*Praktika përmban edhe masa disiplinore të dhëna nga Rektori i UT, mbi bazë të propozimit të Znj. D. P., Dr. e Burimeve Njerëzore*).

4. Me Vendimin nr. 184, datë 19.12.2017, e Rektorit “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës në UT të Znj. A. B., përgjegjëse e Sektorit Juridik”, kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me përgjegjësen e Sektorit Juridik.
5. Me Vendimin nr. 185, datë 19.12.2017, e Rektorit “Për zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës në UT të Znj. F. B.” janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Drejtoreshën e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në UT.

Nga informacioni i përcjellë nga Administratori i UT-së, nëpërmjet shkresës nr. 3231, datë 02.07.2018, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve të administratës së Rektoratit është 66, ndër të cilët 42 punonjëse janë femra dhe 24 punonjes janë meshkuj. Pra, në administratën e Rektoratit, rreth 64 % e punonjeseve është femra dhe 36 % e punonjësve janë meshkuj. Nga këta punonjës, Rektori ka zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëherëshme për shkaqe të justifikuara gjatë vitit 2017 me 5 punonjës, 4 prej të cilave janë femra dhe 1 punonjës mashkull. Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se numri i punonjësve femra është më i madh, fakt që demonstron që Rektori ka ndërmarrë masë për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, kryesisht ndaj kësaj gjinie. Në këtë kontekst, vlen për t’u theksuar fakti se në pozicionin e punës së ankueses, Rektori ka punësuar me kontratë pune 3-mujore, një punonjës mashkull (Z. E.M)<sup>9</sup>, fakt që përforcon pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë.

Për sa më sipër, mbështetur në parashikimin e nenit 7, pika 1, nenit 12, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenit 6, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, Komisioneri gjykon se Znj. A. B. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të gjinisë.

- ⇒ Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes civile” dhe “përgjegjësisë prindërore”, shkaqe këto që lidhen të gjitha në mënyrë të drejtpërdrejtë me gjendjen familjare të ankueses, e cila është e divorcuar, Komisioneri gjykon sërish duke iu referuar pikës 11, të Projekt-Raportit nr. 3411/1, datë 30.03.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe akteve të tjera administrative, ku rezulton se përveç Znj. A. B., kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme dhe të pa justifikuar edhe për punonjës të tjerë të Rektoratit të UT, të cilët nuk kanë statusin e ankueses. Në këto kushte Komisioneri gjykon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së ankueses, nuk ka ardhur si rrjedhojë e diskriminimit të saj, nga ana e Rektorit të UT, për shkaqet e sipërpërmendura.

---

<sup>9</sup> Referuar Vendimit nr. 40, datë 28.03.2018, të Rektorit të UT. “Për emërimin me kontrata pune me afat të caktuar 3 (tre) mujore të personelit ndihmës akademik me karakter administrative në Rektoratin e UT”.



- ⇒ Gjatë shqyrtimit të të gjithë akteve administrative, të depozituara në cilësinë e provës, si dhe duke u mbështetur në përfundimet e seancës dëgjimore, Komisioneri ka konstatuar dhe është vënë në dijeni të konfliktit institucional brenda institucionit të Rektoratit dhe specifikisht konfliktit për kompetencë të Rektorit nga njëra anë dhe të Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nga ana tjetër. Një fakt i tillë u bë mëse i qartë gjatë seancës dëgjimore të realizuar pranë Komisionerit, por u evidentua gjithashtu përgjatë korrespondencës zyrtare, që Komisioneri ka patur me të dy titullarët e këtij institucioni, si dhe provave respektive<sup>10</sup> të depozituara nga palët në këtë proces administrativ.

Nga provat e depozituara rezulton se titullarët e sipërpërmendur nuk bien dakord mbi ndarjen e kompetencave të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Referuar dispozitave përkatëse të këtij ligji, përkatësisht nenit 39 të tij, rezulton se Rektori disponon kompetenca të karakterit akademik, ndërkohë që Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nenet 49 dhe 52 të ligjit të sipërpërmendur u atribuojnë, kompetenca të karakterit administrativ dhe financiar. Në kushtet kur, aktet nënligjore dhe administrative, në bazë të së cilave punon Rektorati nuk janë rifreskuar dhe përshtatur me parashikimet e ligjit në fuqi, por janë ende të

---

<sup>10</sup>-Shkresa nr. 4444, datë 20.10.2017, “Informacion mbi bllokimin institucional të Universitetit të Tiranës”, e Rektorit, të UT, drejtuar Z. E. R., Kryeministër;

-Shkresa nr. 3720, datë 13.09.2017, e rektorit të UT, drejtuar Znj. L. N., Ministër i Arsimit dhe Sportit;

-Shkresa nr. 3721/1, datë 13.09.2017, e Rektorit drejtuar Z. A. A., Ministër i Financave.

-Vendim nr. 116, datë 03.08.2017, i Rektorit, “Për pezullimin nga detyra të Kancelarit të universitetit të Tiranës, R. S.”

-Shkresa nr. 3367, datë 07.08.2017, e Rektorit drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

-Shkresa nr. 606, datë 05.02.2018, e rektorit të UT drejtuar Bordit të Administrimit të UT.

-Shkresa nr. 751, datë 13.02.2018, të Rektorit drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

-Shkresa nr.1047, datë 01.03.2018, e Rektorit drejtuar Bordit të Administrimit të UT;

-Shkresa nr. 1545, datë 03.04.2018, e Rektorit drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

-Shkresa nr. 749, datë 13.02.2018, i Administratorit të UT drejtuar Zv/Rektorit, dekanëve të fakulteteve dhe në vëmendje të Bordit të Administrimit të UT-së;

-Shkresa nr. 942, datë 23.02.2018, e Administratorit të UT-së drejtuar Rektorit dhe për dijeni Bordit të Administrimit të UT-së;

-Shkresa nr. 1012, datë 27.02.2018 e Administratorit drejtuar Ministres së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe për dijeni Anëtarëve të Rektoratit dhe Bordit të Administrimit të UT-së.

-Shkresa nr. 1234/2, datë 20.03.2018 e Administratorit të UT-së drejtuar Rektorit të UT-së dhe Bordit të Administrimit të UT-së.

-Shkresa nr. 1525, datë 30.03.2018, e Administratorit drejtuar Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

-Shkresa nr. 1234, datë 13.03.2018, e Administratorit drejtuar Rektorit të UT-së dhe për dijeni Bordit të Administrimit të UT-së dhe MARS-së.

-Shkresa nr. 1234/1, datë 19.03.2018, e rektorit drejtuar Administratorit të UT-së.

-Shkresa nr. 1136/7, datë 30.03.2018, e Rektorit drejtuar Administratorit të UT-së;

-Shkresa nr. 3626/1, datë 11.04.2018 e MARS-së drejtuar Bordit të Administrimit të UT-së.

mbështetura në parashikimet e ligjit të mëparshëm për arsimin e lartë, kjo lë vënd për interpretime të bazës ligjore, lidhur me kompetencat e dy titullarëve, sidomos për çështjen e punësimit dhe lirimt nga detyra të punonjësve të Rektoratit<sup>11</sup>. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se janë krijuar dy grupe të mirëfillta punonjësish, që mbështesin dhe përkrahin respektivisht Rektorin dhe Administratorin bashkë me Bordin e Administrimit të UT dhe njëkohësisht këta të fundit i përkrahin ata. Kjo vërtetohet sidomos në emërime punonjësish të kryer nga Rektori, si dhe nga Administratori, sikurse vihen re akte administrative për zgjidhje të kontratave të punës për punonjësit nga secili prej titullarëve. Një fakt i tillë është konstatuar edhe në Projekt-Raportin nr. 3411/1, datë 30.03.2018, të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Për sqarimin e çështjes së kompetencave të dy titullarëve u miratua Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, i cili përcakton me hollësi strukturat akademike, ndihmës akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë. Në bazë të gërmës j), të pikës 3, të këtij Udhëzimi, strukturat juridike, ku dikur punonte Znj. A. B., u përcaktuan si struktura ndihmës akademike, pra u konsideruan si struktura, ku emërimet dhe shkarkimet kryhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Rektori.

Konflikti institucional vihet re edhe në rastin e Znj. A. B., ku Bordi i Administrimit, në cilësinë e organit më të lartë kolegjal të Universitetit të Tiranës për çështjet administrative dhe financiare, me Vendimin nr. 28, datë 21.12.2017, ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të Universitetit të Tiranës, si një akt të dalë në kundërshtim me kompetencat funksionale, që Rektori ka në bazë të nenit 39, pika 5, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”<sup>12</sup>. Ndërkohë që në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 188, datë 21.12.2017, të Rektorit të UT, Vendimi i sipërpërmendur i Bordit të Administrimit të UT është shpallur absolutisht i pavlefshëm, si një akt i nxjerrë në tejkalim të kompetencave.

Një gjë e tillë nuk ka ndodhur vetëm në rastin e Znj. A. B., pasi Bordi i Administrimit<sup>13</sup> të Universitetit të Tiranës ka shpallur si absolutisht të pavlefshëm edhe vendime të tjera të Rektorit

---

<sup>11</sup>Pika 5, e nenit 39, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikon shprehimisht: “Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë”. Ndërkohë që pika 12 e po këtij neni parashikon: “Funksione të tjera të rektorit përcaktohen në statutin e institucionit.” Nëse do t’i referohemi pikës 8, të nenit 25 të Statutit të Universitetit të Tiranës, në këtë nen parashikohet shprehimisht: “Rektori është autoriteti më i lartë drejtues, ekzekutiv e urdhërdhënës i UT-së, i cili vec sa është përcaktuar në ligj ka edhe këto detyra dhe kompetenca: ...8. Nënshkruan kontratat e punës për të gjithë personelin në UT”.

<sup>12</sup>Pika 5, e nenit 39, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë”.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 28, datë 20.12.2017, i Bordit të Administrimit të UT-së.

dhe anasjelltas<sup>14</sup>. Në rastin e Znj. A. B. rezulton se edhe pas daljes së Vendimit nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të Universitetit të Tiranës për zgjidhje të kontratës së punës, ajo vazhdon të punojë në Rektorat dhe merr detyra të drejtpërdrejta nga Administratori, fakt që është pohuar gjatë seancës dëgjimore, nga të gjitha palët. Njëkohësisht, gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Rektorit ka theksuar faktin se ndaj Znj. A. B. është humbur besimi dhe se ajo nuk zbatonte hierarkinë. Si rrjedhim, Rektori nuk mund të punonte më me të. Humbja e besimit dhe moszbatimi i hierarkisë nga Znj. A. B., konsistonte në faktin se ajo merrte urdhëra të drejtpërdrejta nga Administratori dhe i zbatonte ato, si dhe bënte pjesë në grupin e të besuarve dhe mbështetësve të Administratorit. Duhet theksuar se humbja e besimit nuk lidhet me aspektin profesional të Znj. A. B., pasi ndaj saj nuk rezulton asnjë akt, veprim apo masë nga ana e Rektorit, që ta vërtetojë, por ka më shumë karakter subjektiv çka përforcon idenë e identifikimit të saj me autoritetet në konflikt me Rektorin.

Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësinë e provës nga ana e Administratorit të UT, rezulton se nga 5 punonjës, të cilëve iu është zgjidhur kontrata e punës të mënyrë të menjëherëshme, pa shkaqe të justifikuara, me vendim të Rektorit, përveç ankueses, vazhdon të punojë ende një punonjëse tjetër, përkatësisht Znj. F. B., Drejtore e Financës dhe Buxhetit, e cila është rikthyer në detyrë pas shpalljes së pavlefshmërisë absolute së Vendimit të Rektorit, nga ana e Bordit të Administrimit të UT. Kjo përforcon faktin se, Rektori ka ndërmarrë masa për ndërprerjen e kontratës së punës, për ata punonjës që zbatojnë urdhërat e Administratorit dhe që konsiderohen si mbështetës të tij.

Në këtë kontekst, rezulton qartë se Znj. A. B. është cilësuar si punonjëse, që bën pjesë në të ashtuquajturin grup mbështetës të Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT dhe në kushtet kur ndaj saj është marrë Vendimi nr. 184, datë 19.12.2017, i Rektorit të Universitetit të Tiranës, motivacioni, i të cilit, është i pambështetur në prova e fakte, Komisioneri gjykon se qendrimi i padrejtë dhe disfavorizues, ndaj të cilit ajo është ekspozuar, nga ana e Rektorit të UT, ka qenë për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Evidentimi i këtij grupi të veçantë nuk lidhet drejtpërdrejt me ato shkaqe të qëndrueshme që listohen në nenin 1, të Ligjit 10221/2010, por konstatohet për shkak të specifikave dhe dinamikave konfliktuale të përkohshme institucionale që janë krijuar në UT edhe si pasojë e konfuzionit të akteve normative të ndryshme, që rregullojnë arsimin e lartë. Mangësia dhe paqartësia e akteve normative, si dhe konflikti midis autoriteve më të larta të UT i ka ekspozuar punonjësit e institucionit në një gjendje pasigurie dhe ndasie duke krijuar raporte besimi dhe mosbesimi të ndërsjellta, të cilat në disa raste janë konkluduar me shkelje ligjore.

---

<sup>14</sup> Vendimi nr. 188, datë 21.12.2017, i Rektorit të UT-së.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja është diskriminuar nga ana e Rektorit të UT për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, shkak ky i parashikuar shprehimisht në nenin 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sikurse edhe në nenin 9, pika 2, të të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Për sa më sipër, në përfundim të analizës së shkaqeve të pretenduara të diskriminimit, duke u mbështetur në parashikimet e nenit 12, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>15</sup>, nenit 9, pikat 1-2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)<sup>16</sup>, si dhe nenit 6, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”<sup>17</sup>, Komisioneri gjykon se ankuesja ndodhet në kushtet e diskriminimit për shkak të “gjinisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”.

---

<sup>15</sup>Neni 12, pika 1, gërma c), i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor **apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**.”

<sup>16</sup> Neni 9, pika 2, i ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjisllacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në **gjininë**, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, **përkatësinë në një grup të veçantë**, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

<sup>17</sup> Neni 6, i ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri” parashikon: “Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. 2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kritereve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njëjës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kritere apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.”

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenin 6, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “gjinisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, të Znj. A. B., nga ana e Z. M. K., Rektor i Universitetit të Tiranës.
2. Marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës, për kthimin e ankuses, në pozicionin e mëparshëm të punës.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Rektori i Universitetit të Tiranës të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

(Shkak: gjinia, përkatësia në grup të veçantë  
Fusha: punësim)